



# MIRË SE VINI NË KOSOVË!

Për të qenë të sigurt në rrugë, Policia e Kosovës apelon që të respektohen rregullat në trafikun rrugor:



## SHPEJTËSIA

Shpejtësia më e madhe e lejuar brenda zonave të banuara është 50 km/h, në qoftë se me shenja të trafikut nuk është e përcaktuar ndryshe.

Në rrugë jashtë zonave të banuara shoferit nuk i lejohet ta ngasë mjetin me shpejtësi më të madhe se sa është e lejuar me shenjë të trafikut:

- në autostradë - 130 km/orë;
- në rrugë të rezervuar për qarkullim të mjeteve motorike - 110 km/orë;
- në rrugë të shpejtë - 100 km/orë;
- në rrugë të tjera - 80 km/orë.



## PËRDORIMI I TELEFONIT

Shoferit të mjetit motorik gjatë kohës së ngasjes nuk i lejohet përdorimi i telefonit mobil dhe pajisjeve të tjera të cilat do ta zvogëlonin mundësinë e reagimit dhe ngasjes së sigurt.



## KËMBËSORËT

Këmbësorët gjatë kalimit të rrugës obligohen që t'i shfrytëzojnë vendkalimet e këmbësorëve, aty ku ato ekzistojnë.



## RRIPI I SIGURISË

Shoferi dhe personat që transportohen në mjetin e pajisur me rripa të sigurisë janë të obliguar që t'i përdorin rripat e sigurisë gjatë lëvizjes së mjetit.

## PËRDORUESIT E TJERË TË RRUGËVE, PËRDORUESIT E PAMBROJTUR TË RRUGËS

Kujdes të shtuar duhet pasur për shfrytëzuesit e rrugëve të vendit të cilët janë si kategori më e ndjeshme apo më e pambrojtur si: motoçiklistët, çiklistët, mopedët, trotinetët, skuterët etj).



## PASOJAT JANË FATALE KUR TEJKALOHET SHPEJTËSIA E LEJUAR

Mbi 50% e aksidenteve me pasoja fatale ndodhin si shkak i mosrespektimit të shpejtësisë së kufizuar,

## MOS SHPEJTO, MBROJ JETËN TËNDE DHE TË TJERËT!